



Ballafaqimi me gratë e kthjera në Ballkanin Perëndimor: sfidat dhe mundësitë nga këndvështrimi i praktikuesit

Autore: **Erinda Bllaca Ndroqi**, Eksperte e jashtme e RNR-së

Radicalisation Awareness Network

RAN 
Practitioners

Ballafaqimi me gratë e kthjera në Ballkanin Perëndimor: sfidat dhe mundësitë nga këndvështrimi i praktikuesit

PARALAJMËRIM JURIDIK

Ky dokument është përgatitur për Komisionin Evropian, por i njëjti reflekton pikëpamjet vetëm të autorit, dhe Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për çfarëdo pasoje të mundshme që mund të gjenerohet nga ripërdorimi i këtij botimi. **Për më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian mund të gjeni në faqen e internetit (<http://www.europa.eu>)**

Luksemburg: Zyra e botimeve e Bashkimit Evropian, 2022

© European Union, 2022



Politika e ripërdorimit e dokumenteve të Bashkimit Evropian zbatohet sipas Vendimit të Komisionit 2011/833/EU me datë 12 dhjetor 2011 për ripërdorimin e dokumenteve të Komisionit (OJ L 330, 14.12.2011. f. 39). Nëse nuk prashihet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti është autorizuar sipas licencës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC-BY 4.0) <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>. Kjo nënkupton se përdorimi ose ripërdorimi lejohet me kusht që t'i jepet njohja e duhur dhe të tregohen ndryshmet e mundshme.

Lidhur me përdorimin ose riprodhimin e elementeve të cilat nuk janë në pronësi të Bashkimit Evropian, do të duhet të kërkohet leje drejtpërdrejtë nga mbajtësit e të drejtave përkatëse.

Hyrje dhe konteksti

Ky punim analizon qasjet ekzistuese ndaj grave të kthyer në Ballkanin Perëndimor (BP), nga këndvështrimi i praktikuesve, duke mbuluar:

- a) **qasjet për riintegrim dhe rehabilitim** në punën me gratë e kthyer nga Siria dhe Iraku në BP, me fokus në integrimin social dhe funksional, kujdesin ndaj traumës, edukimin dhe masat e tjera përkatëse;
- b) **rolet dhe përgjegjësitë** në angazhimin dhe koordinimin ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë si pjesë e qasjeve të rehabilitimit dhe riintegrimin (R&R);
- c) **sfidat** e identifikuar, boshllëqet e kapaciteteve dhe **nevojat** për të adresuar me qëllim që të forcohen ndërhyrjet e ardhshme.

Punimi fokusohet në katër rastet studimore nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Kosova* për shkak të rëndësisë së tyre në rajon kur bëhet fjalë për punën me një numër të konsiderueshëm të rasteve të grave të kthyer, disponueshmërinë e llojeve të ndryshme të programeve për të kthyerit në përgjithësi, dhe mësimet përkatëse të nxjerra në riintegrimin dhe rehabilitimin e grave të kthyer.

Punimi ka tre qëllime kryesore:

- (1) të ofrojë një pasqyrë sistematike të qasjeve ekzistuese të riintegrimin dhe rehabilitimit ndaj grave të kthyer në BP;
- (2) të identifikojë mangësitë dhe nevojat e mbetura;
- (3) dhe në këtë mënyrë të identifikohen mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të qasjeve ekzistuese në punën me gratë e kthyer.

Punimi bazohet në analizën e burimeve të ndryshme për çështjen e të kthyerve në BP, duke përfshirë artikujt e mbledhur dhe protokollet/udhëzimet kombëtare ekzistuese dhe kornizat në lidhje me programet e rehabilitimit në rajonin e BP. Për më tepër, u mbajtën intervista me zyrtarë qeveritarë si dhe me praktikues të vijës së parë në nivel qendror dhe lokal për të identifikuar mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira.

Kthimi vullnetar dhe ai i udhëhequr nga qeveria në BP i mbi 500 individëve që udhëtuan në zonat e konfliktit solli sfida të shumta që ndikuan në proceset e riintegrimin dhe rehabilitimit, veçanërisht kur punohet me gratë dhe fëmijët e kthyer⁽¹⁾. Sot, njihen praktika të ndryshme përmes raporteve dhe rasteve studimore, duke identifikuar nevojën për një qasje holistike që përfshin mbështetje psikosociale, mjekësore, ligjore, arsimore dhe të shëndetit mendor. Megjithatë çdo rast ka elemente të ngjashme përsa i përket shqetësimeve të pritshme psikologjike dhe emocionale, secili rast mbetet unik për sa i përket ndërhyrjeve. Rastet e grave të kthyer në Kosovë* më 20 prill 2019, Bosnjë dhe Hercegovinë⁽²⁾ në dhjetor 2019⁽³⁾, dhe rastet e fundit të riatdhesimit të pesë grave në Shqipëri⁽⁴⁾ kanë treguar se procesi i rehabilitimit, risocializimit dhe riintegrimin kërkon shumë kohë dhe kërkon burime njerëzore dhe kapacitete, si dhe mbështetje të vazhdueshme dhe të harmonizuar nga shumë agjenci.

*Ky kategorizim është pa paragjykim për pozitat lidhur me statusin, dhe është në përputhje me UNSCR 1244 dhe Mendimin e GJND-së për deklaratën për pavarësinë e Kosovës

(1) Shtuni, A. (2020, January 9). *Returning Western Balkans foreign fighters: A long-term challenge*. Instituti Italian për Studime Politike Ndërkombëtare. <https://www.ispionline.it/en/publicazione/returning-western-balkans-foreign-fighters-long-term-challenge-24762>

(2) Bosnja dhe Hercegovina riatdhesoi 25 shtetas në fund të dhjetorit 2019 dhe aktualisht është duke pritur për një mision shtesë.

(3) Perešin, A., Hasanović, M., & Bytyqi, K. (2021). Femrat e kthyer nga Siria në Ballkanin Perëndimor: Mes keqardhjes dhe 'nostalgjisë për kalifatin'. *Perspectives on Terrorism*, 15(5), 29-45. <https://www.universiteitleiden.nl/perspectives-on-terrorism/archives/2021#volume-xv-issue-5>

(4) Riatdhesimet e fundit (2019, 2020 dhe fillimi i vitit 2021) kanë ndodhur në Shqipëri me kthimin e pesë grave dhe 14 fëmijëve.

Qasjet ekzistuese: Sistematizimi

Vitet e fundit, BP është përballur me një sërë sfidash në zhvillimin e programeve për riintegrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve. Pothuajse në të gjitha vendet e rajonit, strategjitë ekzistuese kombëtare për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDH) janë zhvendosur nga një qasje e përfshirjes së gjithë qeverisë në një qasje të përfshirjes së gjithë shoqërisë, duke e lehtësuar mbështetjen e shumë agjencive dhe ndërhyrjet e përshtatura ⁽⁵⁾. Ndërrimi filloi për shkak se autoritetet e BP-së u përballën me nevoja të jashtëzakonshme që e shoqëruan procesin e riatdhesimit. Numri i konsiderueshëm i lartë i grave dhe fëmijëve të kthyer nuk u konsiderua fillimisht si një kërcënim i menjëhershëm për sigurinë kombëtare dhe rajonale dhe stabilitetin e komunitetit, por ai i nënvizoi boshllëqet e kapaciteteve në fushën e risocializimit dhe riintegrimin dhe rehabilitimit në rajon. Parandalimi parësor në punën e P/KEDH, siç është rritja e ndërgjegjësimit, kërkon terminologji të përbashkëta dhe një kuptim të përbashkët të faktorëve lokalë dhe rajonalë që i shtynë njerëzit të udhëtojnë në Siri dhe Irak. Për më tepër, rehabilitimi dhe riintegrimi i të kthyerve, *si procese të parandalimit terciar*, kërkojnë marrëdhënie edhe më të qëndrueshme midis praktikuesve të vijës së parë dhe institucioneve të sigurisë dhe jo-sigurisë, si dhe ndërmjet praktikuesve dhe të kthyerve, për të qenë në gjendje të zhvillojnë besimin që nevojitet për ndërhyrje sociale dhe funksionale.

Kosova:

Kosova ka parë përqendrimin më të lartë të të kthyerve nga Siria dhe Iraku – duke i përfshirë edhe ata të riatdhesuar – në Evropë, në raport me numrin e popullsisë. Ky proces paraqet një rast studimi "per se" kur merret parasysh zhvendosja demografike nga të rriturit meshkuj të riatdhesuar tek gratë dhe fëmijët: kthimi i 110 kosovarëve më 20 prill 2019 solli në vend 32 gra, 74 fëmijë dhe 4 burra. Ndërsa të gjithë burrat u arrestuan, gratë dhe fëmijët e kthyer u karantinuan në një qendër të dedikuar pritjeje ku, gjatë 3 ditëve, ata u kontrolluan mos kanë sëmundje infektive dhe gjithashtu patën kontrolle mjekësore, si dhe vlerësime psikiatrike dhe psiko-sociale. Të gjithë të kthyerit u intervistuan nga punonjësit socialë për të identifikuar nevojat e tyre imediate. Në ekzaminimin e parë, të gjitha 32 gratë e kthyerat u hetuan dhe u mbajtën nën mbikëqyrje të rreptë. Më 3 shtator 2019, Gjykata Themelore e Prishtinës nxori aktgjykimin e parë kundër një gruaje të kthyer e cila u dënua me 2.5 vjet burgim me kusht. Kjo shërbeu si shembull për rastet e mëpasshme. Deri në gusht të vitit 2020, 27 nga 32 gratë të kthyerat morën dënime me burg. Kosova ishte vendi i parë që filloi hetime penale për gratë e kthyerat. Autoritetet publike kanë shpjeguar se shumica e rasteve u pezulluan për shkak të udhëtimeve të këtyre grave në zonat e konfliktit dhe u rihapën pasi të përfundonte procesi i riatdhesimit ⁽⁶⁾.

Me ardhjen e të kthyerve, autoritetet kosovare kanë zbatuar një plan emergjent 72 orësh, të koordinuar nga Divizioni për Parandalim dhe Riintegrim në Ministrinë e Brendshme. Këto 72 orë u përdorën kryesisht për vlerësime mjekësore, psikiatrike dhe psikologjike, si dhe për dërgime në spitale, nëse ishte e nevojshme. Pas zbatimit të planit të emergjencës, gratë dhe fëmijët e kthyer ranë dakord të transferoheshin te familjet e tyre.

Procesi i riintegrimin të një numri të madh të grave dhe fëmijëve të kthyer, së bashku me nevojën për t'i përshtatur këto qasje me profilet e ndryshme, i ka vënë nën presion të madh kapacitetet për rehabilitim dhe riintegrim në Kosovë. Shumica e grave të kthyerat përjetojnë trauma, depresion dhe forma të tjera të çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD) që kërkojnë mbështetje të vazhdueshme. Me rëndësi të veçantë mbetet mbështetja e organizatave ndërqeveritare dhe ndërkombëtare për t'u ofruar grave të riatdhesuara trajnime prindërore dhe plane mbështetëse për riintegrimin ekonomik ⁽⁷⁾.

Për shkak të nevojës në rritje për vazhdimësi të ndërhyrjeve, qasja e rehabilitimit të udhëhequr nga qeveria u hap ndaj kontributeve nga aktorët e shoqërisë civile, pasi ato ishin me bazë lokale dhe shpesh gëzonin

⁽⁵⁾ Parimet që janë miratuar në Manualin e RNR mbi rehabilitimin e shkelësve të radikalizuar dhe terroristë për praktikuesit e linjës së parë.

⁽⁶⁾ Shih: <https://www.zeramerikes.com/a/kosovo-syria-/4887472.html>

⁽⁷⁾ Organizata Ndërkombëtare për Migracionin. (2020). *Reintegration of returning foreign terrorist fighters (RFTF) and their families from conflict zones. Intervention factsheet.* https://albania.iom.int/sites/g/files/tmzbd1401/files/inline-files/pcve_project-factsheet-reintegration-of-rftfs_ongoing_0.pdf

qasje dhe përvojë të pakufizuar me grupet e marginalizuara dhe lidhje të mira me strukturat e qeverisjes lokale dhe komunitetet ⁽⁸⁾.

Mundësitë	Mangësitë dhe nevojat
<p>Riatdhesimi si një mundësi për të mbështetur rehabilitimin dhe riintegrimin e grave të kthyer:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qasja dinamike ndaj vlerësimit të nevojave po përdoret për t'iu përshtatur nevojave në ndryshim • Qasja ndër-profesionale ndaj masave të riintegrit funksional dhe social • Procese të mira për të identifikuar dhe kontaktuar familjet e origjinës • Disponueshmëri e gjerë e informacionit bazë dhe të qasshëm për gratë e kthyer për t'iu informuar për procesin e tyre të kthimit • Një proces i udhëhequr nga qeveria që e lehtëson përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile gjatë rehabilitimit dhe riintegrit 	<p>Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria në proceset e menaxhimit të rasteve mbeten sfidë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e lartë e largimit të punonjësve dhe rraskapitja e tyre • Mungesa e gatishmërisë së organeve të pushtetit lokal • Mungesa e vazhdimësisë së vlerësimit të rrezikut dhe nevojave • Nevoja për financim adekuat • Mundësi të kufizuara ekonomike dhe punësim i qëndrueshëm për riintegrimin e grave të kthyer • Mangësitë në vlerësimin e rrezikut dhe nevojave të grave të kthyer dhe radikalizimi i tyre i mundshëm pas kthimit në familjet e origjinës • Nevojitet më shumë angazhim me komunitetet lokale për të nxitur risocializimin dhe pranimin nga komuniteti

Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina përdori një qasje "të butë" me gjashtë gratë e para që u riatdhesuan në dhjetor të vitit 2019: asnjëra prej tyre nuk u soll para gjykatës për shkak të bashkimit me SHI-në ⁽⁹⁾ pasi u shpallën dëshmitare të paafta për shkak të pasojave të traumës që i kishin përjetuar në zonat e konfliktit ⁽¹⁰⁾.

Ministria e Sigurisë është autoriteti përgjegjës për programin e riatdhesimit, i cili filloi me një fazë të para mbërritjes, duke përfshirë organet përgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal. Faza e pritjes përfundoi me vlerësimin 10-ditor të rrezikut dhe nevojave që përfshinte vlerësime shëndetësore dhe psikologjike, intervista fillestare dhe strehim të përkohshëm. Pas pritjes, procesi vazhdoi me krijimin e një ekipi të lëvizshëm mentorimi që i ndihmonte gratë e kthyer për të gjetur shërbime psikologjike në komunitetet e tyre.

Fondi i Riintegrit dhe Mbështetjes Financiare për të Kthyerit dhe Familjet e tyre u krijua në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim, me qëllim që të mbështesë të kthyerit dhe familjet e tyre për të filluar punë të reja dhe për të arritur pavarësinë financiare.

Ajo që e dallon profilin e grave boshnjake të kthyer nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është niveli i tyre mesatar i ulët ekonomik, niveli i arsimimit dhe origjina e tyre nga zonat urbane. Gratë e kthyer ishin të arsimuara mirë, me të paktën shkollë të mesme (katër), deri në universitet (një), e madje edhe me diplomë masteri (një). Pranimi dhe kthimi në komunitetet e tyre i ndihmoi gratë e kthyer të kapërcenin stigmën fillestare dhe të merrnin ndihmë për vuajtjet dhe traumat e tyre. Megjithatë, ka disa shqetësime në lidhje me efikasitetin e programeve të deradikalizimit për gratë e kthyer, pasi nuk ka mbështetje shtesë për ndjekjen dhe vlerësimin e përvojave të tyre personale ⁽¹¹⁾. Përtej shkallës në të cilën ato mund të riintegroheshin në familje dhe shoqëri, sukcesi i riintegrit të grave të kthyer do të varet shumë edhe nga perspektivat e tyre ekonomike. Fitimi i pavarësisë ekonomike mund të jetë një faktor për t'i larguar njerëzit nga rrjetet dhe narrativat ekstremiste ⁽¹²⁾.

⁽⁸⁾ Burimi: Intervistë me Dr. Feride Rushitin, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës.

⁽⁹⁾ Bosnja dhe Hercegovina është e njohur për shkallën e ulët të dënimit të luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer (LHT). Gjykata shtetërore e Bosnjës ka gjykuar dhe dënuar 46 persona që janë kthyer nga Siria apo Iraku gjatë viteve të fundit.

⁽¹⁰⁾ Perešin, A., Hasanović, M., & Bytyqi, K. (2021). Femrat e kthyer nga Siria në Ballkanin Perëndimor: Mes keqardhjes dhe 'nostalggjisë për kalifatin'. *Perspectives on Terrorism*, 15(5), 29-45. <https://www.universiteitleiden.nl/perspectives-on-terrorism/archives/2021#volume-xv-issue-5>

⁽¹¹⁾ Jahic, D., Jahic, A., & Sahinkaya, E. (2021, May 17). *Pandemic adds to fear for Bosnians awaiting repatriation of families in Syria*. Voice of America. <https://www.voanews.com/a/extremism-watch-pandemic-adds-fear-bosnians-awaiting-repatriation-families-syria/6205929.html>

⁽¹²⁾ Perešin, A., Hasanović, M., & Bytyqi, K. (2021). Femrat e kthyer nga Siria në Ballkanin Perëndimor: Mes keqardhjes dhe 'nostalggjisë për kalifatin'. *Perspectives on Terrorism*, 15(5), 29-45. <https://www.universiteitleiden.nl/perspectives-on-terrorism/archives/2021#volume-xv-issue-5>

Mundësitë	Mangësitë dhe nevojat
<p>Riatdhesimi si një mundësi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procese të mira për të identifikuar dhe kontaktuar familjet e origjinës • Nuk ka dënime për gratë e kthyer (kjo e bën më të lehtë zbatimin e programeve të riintegrit) • Angazhimi proaktiv i organizatave të shoqërisë civile lokale dhe atyre të udhëhequra nga gratë në rehabilitim dhe riintegrim 	<p>Programet e rehabilitimit nuk janë analizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e shqyrtimit të kërcënimeve të mundshme të radikalizimit të mëtejshëm pas kthimit në familjet e origjinës • Mungesa e stimuljeve për punësim të qëndrueshëm • Mungesa e gatishmërisë së organeve të pushtetit lokal • Nevojitet më shumë angazhim me komunitetet lokale për risocializimin dhe pranimin nga komuniteti

Republika e Maqedonisë së Veriut

Përpjekjet e udhëhequra nga qeveria për riatdhesimin e shtetasve që udhëtuan në Siri dhe Irak filluan në vitin 2018 me riatdhesimin e 7 shtetasve; vazhduan me riatdhesimin e 3 grave në vitin 2019 dhe, së fundmi, të 5 grave, 14 fëmijëve dhe 4 burrave në vitin 2021 ⁽¹³⁾.

Para procesit të riatdhesimit, agjencitë qeveritare të Republikës së Maqedonisë së Veriut filluan fazën përgatitore me sigurimin e infrastrukturës dhe objekteve pritëse, trajnimeve dhe koordinimit me aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe joshtetërorë. Në vitin 2020, parlamenti i Maqedonisë së Veriut miratoi një qasje holistike ndaj rehabilitimit isocializimit dhe riintegrit të grave dhe fëmijëve të kthyer, duke i integruar komunitat qendrore dhe lokale në ndërhyrjet individuale të përshtatura për të kthyerit.

Me të mbërritur, gratë dhe fëmijët e kthyer mbahen në qendrat e pritjes kufitare për ekzaminimet e para mjekësore dhe psikologjike, e ndjekur nga një fazë karantine 14-ditore ku bëhet vlerësimi i rrezikut dhe nevojave dhe përfundimi i hetimeve të mëtejshme penale për çdo përfshirje të mundshme kriminale të grave të kthyer. Pas fazës së karantinës, gratë e kthyer transferohen në komunitetet lokale dhe familjet e tyre, ndërsa burrat e kthyer ndalohen dhe transferohen në objektet e paraburgimit ⁽¹⁴⁾.

Procesi i rehabilitimit gjatë transferimit të grave të kthyer në komunitetet lokale paraqitet si një ndërhyrje e bashkërenduar që përfshin masa ligjore, mjekësore, psikologjike, sociale, ekonomike dhe fetare dhe reflektohet në planet individuale të trajtimit. Këto plane individuale hartohen nga autoritetet lokale dhe miratohen në nivele qendrore. Kjo metodologji është pjesë e qasjeve të shumë agjencive që i ndjekin proceset e rehabilitimit dhe riintegrit.

Zbatimi dhe ndjekja e rasteve janë përballur me sfida të ndryshme, veçanërisht në komunitat që aktualisht i ndjekin proceset e riintegrit të grave të kthyer. Nga 14 komuna (hotspots), Qendra për Punë Sociale, e cila është autoriteti përgjegjës për ndjekjen e planeve individuale të trajtimit, ka krijuar vetëm shtatë ekipe lokale multidisiplinare për shkak të mungesës së strukturave lokale në secilën komunë dhe mungesës së stafit. Ekipet lokale multidisiplinare janë të mbingarkuara për të ndjekur zbatimin e planeve individuale të trajtimit, për të vlerësuar progresin dhe për të rekomanduar dhe referuar rastet në përputhje me rrethanat në të gjitha 14 komunitat.

⁽¹³⁾ Të dhënat zyrtare thonë se numri i LHT-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është 156. Shih: <https://www.icsve.org/isis-repatriations-in-north-macedonia/>

⁽¹⁴⁾ Vanchoski, A., Shikova, N., & Musliu, A. (2020). *Enhancing the understanding of foreign terrorist fighters (FTF): Challenges for rehabilitation, resocialization and reintegration of returnees in the Republic of North Macedonia*. NEXUS Civil Concept. https://kbb9z40cmb2apwafcho9v3j-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2018/01/nexus_ftf_rrr_eng.pdf

Komisioni Evropian (2018, April 17). *Commission staff working document. The former Yugoslav Republic of Macedonia 2018 Report*. European Commission, SWD(2018) 154 final. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> (p. 38).

Mundësitë	Mangësitë dhe nevojat
<p>Proceset e riadhesimit si një mundësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qasja me përfshirje të shumë agjencive që i kombinon dhe adreson nevojat e individëve të kthyer (nga institucionet e sponsorizuara nga shteti në nivel qendror dhe institutet kërkimore deri te bashkitë/komunat lokale dhe OJQ-të) • Nuk ka dënime për gratë e kthyer (kjo e bën më të lehtë zbatimin e programeve të riintegritimit) • Angazhimi proaktiv i organizatave të shoqërisë civile lokale dhe atyre të udhëhequra nga gratë si dhe i komunitetit akademik në rehabilitim dhe riintegrim • Mundësi për të punuar së bashku në kuptimin dhe adresimin e kontekstit multikulturor dhe multi-konfesional të Maqedonisë 	<p>Programet e rehabilitimit nuk janë analizuar plotësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat e mirëqenies sociale me staf të pamjaftueshëm që tregojnë mungesë të arsimimit dhe përvijës së profilizuar në trajtimin e çështjeve/programeve të P/KEDH • Mungesa e një forme më të strukturuar të bashkëpunimit midis të gjitha palëve të interesuara në mjedisin kombëtar • Mungesa e gatishmërisë së organeve të pushtetit lokal • Nevojitet më shumë angazhim me komunitetet lokale për risocializimin dhe pranimin nga komuniteti • Kuptimi më i mirë i zhvendosjes graduale të proceseve të radikalizimit dhe shpërndarjes së narrativave ekstremiste në hapësirat më pak të dukshme në internet

Shqipëria

Shqipëria u përball me riadhesimet vullnetare të 30 burrave, 7 grave dhe 8 fëmijëve gjatë periudhës 2012-2019. Më pas, qeveria shqiptare u angazhua drejtpërdrejt në dy misione riadhesimi, duke sjellë në vend 5 gra dhe 14 fëmijë. Në vitin 2019, qeveria shqiptare, në koordinim me Qendrën Kombëtare të Koordinimit për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC), hartuan një program pilot që i formësoi proceset e rehabilitimit dhe riintegritimit për riadhesimet vullnetare, duke përfshirë 12 gra, 23 fëmijë dhe 13 burra. Si pjesë e programit, të zbatuar nga Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshime Sociale në një bashki, praktikuesit e vijës së parë ishin në gjendje të ndërtonin njohuri, ekspertizë dhe informacion mbi sfidat dhe mësimet e nxjerra në hartimin dhe zbatimin e planeve të ndërhyrjes. Kjo ishte përpjekja e parë pilot me shumë palë të interesuara që çoi në përgatitjen e një Plani Kombëtar të Veprimit ndër-institucional për Riadhesimin.

Sipas planit të veprimit ndër-institucional, procesi i pritjes është projektuar në faza të ndryshme që përfshijnë momentin e mbërritjes, kontrollin e parë të shpejtë dhe transferimin në qendrën e pritjes për ekzaminime të thelluara mjekësore, psikologjike dhe psikiatrike (faza e karantinës 14-ditore). Gjatë kësaj faze, autoritetet nga agjenci të shumta janë në gjendje të zhvillojnë plane individuale trajtimi dhe të caktojnë strukturat vendore bashkiake për të ndjekur procesin e riintegritimit.

Në rastin e Shqipërisë, gratë e kthyer kërkojnë të akomodoheshin në kryeqytet dhe jo me familjet e tyre të origjinës, për shkak të frikës së refuzimit, stigmatizimit dhe statusit të tyre të paqëndrueshëm psikologjik që mund të kërkonte shërbime të specializuara terciare. Ata kanë treguar shenja të dukshme të PTSD-së, ankth, sulme të shpeshta paniku, depresion dhe mungesë gjumi. Pothuajse të gjitha kishin frikë se mos i humbnin fëmijët e tyre. Disa prej tyre shprehnin frikë të vazhdueshme nga stigmatizimi i tyre dhe i fëmijëve të tyre.

Gjithashtu, strukturat bashkiake u përballën me vështirësi në gjetjen e strehimit të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për gratë e kthyer, ndihmë me regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe shkolla fillore, ndihmë me mësuesit e caktuar ndihmës, mbështetje psikologjike, mbështetje financiare për qira dhe orendi, mjekim, ushqim dhe materiale, sesione orientimi për punësim etj.

Burime zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve raportojnë një grua të kthyer në paraburgim për një veprë të lidhur me terrorizmin.

Mundësitë	Mangësitë dhe nevojat
<p>Proceset e riatdhesimit si një mundësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prioritetet politike dhe të sigurisë së qeverisë për kthimin e qytetarëve shqiptarë • Programet e mëparshme pilot që kanë prioritetuar ndërhyrjet bazë dhe planet individuale të trajtimit • Trajnimi paraprak dhe ngritja e kapaciteteve për praktikuesit e vijës së parë, edukatorët dhe personelin e zbatimit të ligjit • Përfshirja e aktorëve të shoqërisë civile si qendra burimore 	<p>Programet e rehabilitimit nuk janë analizuar plotësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nevoja për role të caktuara të aktorëve lokalë, për të shmangur mbivendosjet. Në këtë mënyrë, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit do të ndihmojnë me ndërhyrjet e rehabilitimit dhe riintegrimin • Burgjet dhe autoritetet e provës duhet të përfshihen si pjesë e proceseve të rehabilitimit me role që ndihmojnë në prioritetimin e ndërhyrjeve dhe ndjekjen e lirim të ose aplikimit të dënimeve alternative • Vëmendje e veçantë ndaj burimeve njerëzore për shëndetin mendor • Nuk ka sistem që mund ta zvogëlojë rraskapitjen profesionale

Mangësitë dhe nevojat e identifikuar në fazat e ndryshme të rehabilitimit dhe riintegrimin për partnerët e BP:

- Mungesa e gatishmërisë dhe burimeve në qendrat e pritjes së urgjencës (ose të ndalimit) ose pikat e para ekuivalente të mbërritjes për të kthyerit, duke përfshirë mungesën e objekteve dhe boshllëqet në procesin e planifikimit menjëherë pas kthimit të grave.
- Barrierat gjuhësore dhe mungesa e profesionistëve të specializuar (të shëndetit, shëndetit mendor, mbështetja psikologjike) e pengojnë më tej punën me gratë e kthyerat që mund të jenë të largëta, shumë të qeta dhe ndonjëherë rezistente ndaj kontaktit të parë me autoritetet shtetërore.
- Mungesa e komunikimit thelbësor vazhdon të dëmtojë krijimin e besimit me gratë e kthyerat, gjë që mund të ketë efekte negative në planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve në rehabilitim dhe riintegrim. (Nevoja për pajtueshmëri me parimin "mos bëj dëm".)
- Gjatë procesit të riatdhesimit/negociatave për t'u kthyer, keqinformimi rreth trajtimit të grave të kthyerat pas kthimit të tyre mund të shkaktojë frikë, refuzim, apo edhe kërcënime nga rekrutuesit në kampet në Siri dhe Irak. Nevojitet sigurimi i informacionit të qartë dhe relevant, si dhe praktik dhe në një gjuhë të lehtë për t'u kuptuar për të forcuar ndërgjegjësimin për procesin e riatdhesimit dhe rehabilitimit dhe riintegrimin të të kthyerave. Duhet të investohen burime për të forcuar besimin në proces.
- Rehabilitimi: pas mbërritjes, gratë e kthyerat zakonisht mbahen në qendrat e pritjes për rreth 72 orë, pasuar nga ekzaminimet mjekësore dhe psikosociale, identifikimi i nevojave dhe në disa raste fillimi i procedurave gjyqësore. Më pas, fillon faza e rehabilitimit në qendrën e pritjes me programe të përshtatura për çdo rast individual. Njësitë qeveritare përgjegjëse për procesin e rehabilitimit nisin një proces menaxhimi të rasteve për të bashkë-hartuar planin mbështetës për gratë e kthyerat.
 - Mungesa e përvojës, ekspertizës dhe informacionit nga ekipet e psikologëve, punonjësve socialë, stafit mjekësor, mësuesve, pastruesve dhe kujdestarëve që punojnë me gratë e kthyerat.
 - Kushtet e punës dhe presioni i kohës për praktikuesit e vijës së parë janë sfiduese pa kompensim adekuat për ekspertizën e nevojshme. Mbështetja nga OSHC-të lokale ka qenë thelbësore në adresimin e këtyre sfidave.
 - Aftësia për të parashikuar nevojat fizike dhe psikologjike të grave të kthyerat është e kufizuar duke pasur parasysh mungesën e njohurive dhe komunikimit me praktikuesit që punojnë me klientët në kampe. Mangësitë e tilla mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e ndërhyrjeve në fazat e riintegrimin.

- Ekziston një nevojë urgjente që stafi i urgjencës të dijë se si të identifikojë shenjat e dhunës, dhunës fizike ose seksuale, PTSD-së, depresionin ose çrregullime të tjera të rënda të shëndetit mendor.

Mundësitë e identifikuara:

- Përpjekjet e rehabilitimit dhe riintegrit mund të përmirësohen duke nxitur bashkëpunimin efektiv të shumë agjencive ndërmjet njërive qeveritare, si dhe përmes përfshirjes së aktorëve joqeveritarë dhe ekspertëve në proceset e menaxhimit të rasteve.
- Përtej shkallës në të cilën ato mund të riintegrohen në familje dhe shoqëri, e ardhmja e grave të kthyer dhe suksesi i riintegrit të tyre do të varen ndjeshëm nga statusi i tyre ligjor dhe nga perspektiva e tyre ekonomike. Fitimi i pavarësisë ekonomike mund të jetë një faktor për t'i larguar njerëzit nga rrjetet dhe narrativat ekstremiste.
- Specializimi dhe trajnimi i profesionistëve të vijës së parë mund të jetë një vlerë e shtuar në krahasim me përfshirjen e institucioneve të reja për të shmangur “zinxhirët” e gjatë të komunikimit. Shmangia e ndryshimit të shpeshtë të praktikuesve në punën me gratë e kthyer është thelbësore për të reduktuar humbjen e besimit ndërmjet klientit dhe ofruesit të shërbimit dhe për të siguruar këshillim të mirë.
- Rëndësia e përgatitjes së një mjedisi të favorshëm nuk mund të mbivlerësohet. Komunitetet pritëse dhe punëtorët e vijës së parë duhet të përgatiten për përfshirjen e grave të kthyer dhe nevojat e tyre specifike për riintegrim përmes proceseve në pronësi të përbashkët dhe planeve të veprimit të zhvilluara mirë, procedurave standarde operative dhe trajnimeve përgatitore.
- Praktikant e mira në punën rehabilituese përfshijnë gjithashtu përgatitjen e komuniteteve për gratë e kthyer, në mënyrë që të reduktohet dyshimi dhe mosbesimi. Këto përpjekje duhet të sigurojnë gjithashtu që ndihma e nevojshme që u jepet (p.sh. ndihma për strehim, mbështetja për të gjetur një punë ose për t'u kthyer në shkollë) të mos perceptohet si konkurrencë e padrejtë ose diskriminim ndaj anëtarëve të tjerë brenda komunitetit.
- Riintegrimi është faza përfundimtare që nuk ofron një ide të qartë të kornizës kohore, nevojave apo kushteve që ndryshojnë. Ndërtimi i një mjedisi të favorshëm për riintegrim është një fushë ku puna e organizatave lokale dhe praktikuesve ka qenë e rëndësishme në adresimin e sfidave rreth stigmatizimit të grave të kthyer, familjeve të tyre dhe komuniteteve në të cilat janë riintegruar. Shumë aktivitete mbështetëse për të kthyerit dhe anëtarët e komunitetit të tyre tashmë po zhvillohen dhe kërkojnë burime dhe mbështetje adekuate për t'u rritur edhe më shumë. Kjo përfshin, por nuk është e kufizuar vetëm në, mbështetjen psikosociale, këshillimin, trajnimin profesional, mundësitë e punësimit, mbështetjen për çështje administrative, si marrjen e certifikatave të lindjes, dhe aktivitete edukative dhe argëtuese për gratë dhe fëmijët e tyre shoqëruar.

Mësimet kryesore të nxjerra dhe rekomandimet

Gjatë përbashkës me gratë e kthyer, disa partnerë të BP-së kanë zhvilluar programe të përbashkëta me përfshirje të shumë agjencive që janë të orientuara drejt programeve të rehabilitimit të bazuara në komunitet. Programet e tilla kanë integruar procedura specifike gjinore që janë të orientuara drejt menaxhimit të traumës dhe dhunës.

1. Një qasje e koordinuar, me role dhe përgjegjësi të qarta të profesionistëve në shumë nivele, është parakusht për identifikimin e nevojave dhe zhvillimin e programeve konsensuale të trajtimit dhe rehabilitimit për gratë e kthyer. Një qasje e tillë e koordinuar do të shmangte dyfishimin e aktiviteteve apo konkurrencës dhe do të nxiste programim dhe sinergji të qëndrueshme.
2. Qasja në informacion për gratë e kthyer në lidhje me proceset e riatdhesimit të ofruara nga qeveria dhe fazat e ndryshme që pasojnë përpjekjet e rehabilitimit mund të jetë një rrugë e mirë për të luftuar stigmatizimin dhe për të ndërtuar besimin mes tyre. Nëse kombinohet me plane të qarta dhe të miratuara, informacioni i lehtë për t'u kuptuar i përfaqëuar nga gratë e kthyer mund të bëhet një shtytës drejt rehabilitimit dhe rinteprimit të tyre të qëndrueshëm. Puna me gratë e kthyer mund të fuqizojë tregime bindëse dhe qasje parandaluese. Duke prezantuar plane të qarta trajtimi që i angazhojnë ato dhe familjet e tyre të origjinës në mënyrë proaktive, praktikuesit e vijës së parë mund të lehtësojnë procese më të buta riinteprimit. Këto ndërhyrje konkrete dhe të përshtatura në BP mund të ndihmojnë në shtytjen e proceseve të riatdhesimit me shembuj të mirë.
3. Përfshirja e komunitetit është kritike për suksesin e përpjekjeve të rehabilitimit dhe rinteprimit. Kur bëhet fjalë për riinteprimin, qeveritë duhet të punojnë me komunitetet për të reduktuar stigmatizimin e grave të kthyer. OShC-të mbeten partnerë strategjikë për t'u angazhuar në iniciativat e P/KEDH, duke i përfshirë përpjekjet për rehabilitim dhe rinteprim: ato janë të bazuara në nivel lokal, gëzojnë qasje të pakrahasueshme në komunitete dhe kanë njohuri unike për dinamikat përkatëse që mund të ndihmojnë ose të pengojnë riinteprimin e grave të kthyer në shoqëri.

Mirënjohje

Autorja është mirënjohëse për saktësinë dhe informacionin në kohë të ofruar nga Qendra Shqiptare e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Faleminderit të gjithë ekspertëve dhe praktikuesve të vijës së parë nga rajoni, të kontaktuar përmes takimeve, e-maileve dhe intervistave, për mendimet e tyre frymëzuese.

Rreth autores:

Erinda Bilaca Ndroqi (Dr.) është studiuese ligjore dhe praktikuese e të drejtave të njeriut. Ajo është drejtoreshë ekzekutive e Institutit Shqiptar për Aktivizëm dhe Ndryshim Social. Organizata e saj është e njohur për zbatimin e programit të parë pilot për rehabilitim dhe riinteprim të luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer dhe familjeve të tyre. Ajo është konsulente kombëtare e programit HELP të Këshillit të Evropës dhe aktualisht e zbaton një program kushtuar rolit të sistemit të burgjeve gjatë rehabilitimit dhe riinteprimit të të burgosurve të dënuar për terrorizëm në Shqipëri.

Bibliografia

- Avdimetaj, T., & Coleman J. (2020). *What EU Member States can learn from Kosovo's experience in repatriating former foreign fighters and their families*. Clingendael Netherlands Institute of International Relations. https://www.clingendael.org/sites/default/files/2020-06/Policy_Brief_Kosovo_experience_repatriating_former_foreign_fighters_May_2020.pdf
- Azinović, V. (2020). *Rehabilitation and reintegration of returning foreign terrorist fighters (RFTFs) and their families in the Western Balkans*. Global Community Engagement and Resilience Fund. <https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-RNA-Western-Balkans-final.pdf>
- Meines, M., Molenkamp, M., Ramadan, O., & Ranstorp, M. (2017). *RAN Manual – Responses to returnees: Foreign terrorist fighters and their families*. Radicalisation Awareness Network. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/ran_br_a4_m10_en.pdf
- Organization for Security and Co-operation in Europe. (2020, January 28). *Non-custodial rehabilitation and reintegration in preventing and countering violent extremism and radicalization that lead to terrorism: A guidebook for policymakers and practitioners in south-eastern Europe*. <https://www.osce.org/secretariat/444838>
- Perešin, A., Hasanović, M., & Bytyqi, K. (2021). Female returnees from Syria to the Western Balkans: Between regret and 'caliphate nostalgia'. *Perspectives on Terrorism*, 15(5), 29-45. <https://www.universiteitleiden.nl/perspectives-on-terrorism/archives/2021#volume-xv-issue-5>
- Perešin, A., & PISOIU D. (2021). *Repatriated foreign terrorist fighters and their families: European experiences & lessons for P/CVE*. Publications Office of the European Union. https://ec.europa.eu/home-affairs/document/download/1b9eec31-b7d7-462c-872b-6f0021b8ab6d_en
- Radicalisation Awareness Network. (2017). *Strengthening community resilience to polarisation and radicalisation*. https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/en?file=2020-09/ran_yf_c_strengthening_community_resilience_29-30_06_2017_en.pdf
- Radicalisation Awareness Network. (2019). *Preventing radicalisation to terrorism and violent extremism. Approaches and practices*. https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2021-05/ran_collection_approaches_and_practices_en.pdf
- Rosand, E., Ellis, H., & Weine, S. (2020, September 14). *Repatriating ISIS family members: A North Macedonian model?* Just Security. <https://www.justsecurity.org/72420/repatriating-isis-family-members-a-north-macedonian-model/>
- Ruf, M., & Jansen, A. (2019). *Study visit: Returned women and children – Studying an ongoing experience on the ground*. Radicalisation Awareness Network. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/ran_study_visit_kosovo_11_10122019_en.pdf
- United Nations Office on Drugs and Crime (2016). *Handbook on the management of violent extremist prisoners and the prevention of radicalization to violence in prisons*. United Nations. https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/Handbook_on_VEPs.pdf
- Walkenhorst, D., Baaken, T., Ruf, M., Leaman, M., Handle, J., & Korn, J. (2020). *Rehabilitation Manual – Rehabilitation of radicalised and terrorist offenders for first-line practitioners*. Radicalisation Awareness Network. https://ec.europa.eu/home-affairs/networks/radicalisation-awareness-network-pan/publications/rehabilitation-manual-rehabilitation-radicalised-and-terrorist-offenders-first-line-practitioners_en

GJETJA E INFORMACIONIT RRETH BE-SË

Online

Të dhëna lidhur me Bashkimin Evropian në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së gjendet në ueb-faqen e Evropës në: https://europa.eu/european-union/index_en

Botimet e BE-së

Mund të shkarkoni ose ta porositni publikime të BE-së falas dhe me pagesë nga: <https://op.europa.eu/en/publications>. Shumë kopje të botimeve falas mund të gjenden duke kontaktur Europe Direct ose qendrën tuaj lokale të informimit (shih https://europa.eu/european-union/contact_en).

Ligjet e BE-së dhe dokumentet përkatëse

Për qasje në të dhëna legale nga BE-ja, duke përfshirë të gjitha ligjet e BE-së që nga viti 1952 në të gjitha versionet në gjuhët zyrtare, shkoni në EUR-Lex në: <http://eur-lex.europa.eu>

Të dhëna të hapura nga BE-ja

Portali i të dhënave të hapura të BE-së (<http://data.europa.eu/euodp/en>) provides access to datasets from the EU. Të dhënat mund të shkarkohen dhe ripërdoren falas, për qëllime komerciale dhe jokomerciale.

Radicalisation Awareness Network

RANI

Practitioners



Publications Office
of the European Union